

## Mekanizmi i ankesave dhe pretendimeve

Ky mekanizëm reagimi synon të marrë dhe t'u përgjigjet pyetjeve, komenteve, sugjerimeve, shqetësimeve dhe ankesave nga të gjitha palët e interesuara të prekura nga qeverisja e zonës së mbrojtur, duke përfshirë, por pa u kufizuar, komunitetet lokale që jetojnë brenda ose pranë zonave të mbrojtura. Mekanizmi synon të sigurojë një mjet lehtësisht të aksesueshëm, transparent dhe konfidencial për palët e interesuara për të dhënë komentet/ankesat e tyre.

Të gjitha komunitetet lokale dhe palët e tjera të interesuara për Qeverisjen e Zonës së Mbrojtur (ZM) mund të ngrenë ankesë me Ekipin përkatës të Komitetit të Menaxhimit (KM), duke zbatuar mekanizmin e ankesave si më poshtë:

**1) Paraqisni komente zyrtare me e-mail ose letër pranë sekretarisë respektive të Administratës së Zonave të Mbrojtura (AdZM).** Përdorni formatin ([Formulari i Ankesës.pdf](#)) ([Formulari i Ankesës.Word](#)) :

**a. Për Parkun Kombëtar të Alpeve të Shqipërisë ([Harta](#))**

Detajet e Kontaktit të ADZM Shkodër:

Adresa Fizike: Administrata e Zonave të Mbrojtura Shkodër, Dobraç, Shkodër, Shqipëri;

E-mail: [agim.dardha@akzm.gov.al](mailto:agim.dardha@akzm.gov.al)

Detajet e Kontaktit të ADZM Kukës:

Adresa Fizike: Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura, Kukës,

E-mail: [lefter.gjana@akzm.gov.al](mailto:lefter.gjana@akzm.gov.al)

- 2) Të gjitha reagimet/ankesat merren nga menaxheri i reagimeve/ankesave pranë AdZM respektive i cili do t'i regjistrojë në regjistrin e reagimeve/ankesave
- 3) AdZM dërgon brenda 2 ditëve të punës, mirënjohjen për reagimin/ankesat e lëshuar me e-mail. Nëse reagimet/ankesat janë dorëzuar me letër me postë, mirënjohja do të lëshohet me postë brenda 10 ditëve pune.
- 4) Pasi të regjistrohet, menaxheri i reagimeve/ankesave pranë AdZM do të vlerësojë përshtatshmërinë mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në politikën e transparencës, nëse është e pranueshme, menaxheri do t'ia referojë atë KM përkatës.
- 5) Komentet e papërshtatshme do të lëshohen me një përgjigje që shpjegon pse reagimi/ankesa nuk do të adresohen nga KM dhe nëse është e mundur do të sugjerohet rruga më e përshtatshme që duhet ndjekur për të marrë një përgjigje.
- 6) AdZM do të zhvillojë një përgjigje brenda 15 ditëve të punës, e cila do të shqyrtohet nga KM.
- 7) Të gjitha komentet dhe përgjigjet do të regjistrohen në regjistrin e reagimeve/ankesave të KM.

- 8) AdZM i komunikon përgjigjen personit(ave) që kanë paraqitur reagim/ankesë pas 20 ditësh pune nga marrja e komenteve. Nëse do të nevojitet më shumë kohë se kaq, duhet t'i sigurohet një përditësim personit që ka paraqitur ankesë/reagim brenda 20 ditëve të punës.
- 9) Personit që ka paraqitur reagim/ankesë do t'i kërkohet t'i përgjigjet zgjidhjeve/veprimeve të propozuara për të treguar nëse janë të kënaqur apo jo. Nëse po, rasti do të mbyllet nëse jo, çështja do t'i kthehet KM për të rivlerësuar veprimin e propozuar.
- 10) Nëse ankuesi nuk është i kënaqur me përgjigjen, ose nëse ankuesi dëshiron të paraqesë një ankesë tjetër në lidhje me shqetësimin e ngritur, kjo ankesë mund të paraqitet pranë Prefektit të prefekturës që kryeson KM:

**a. Për Parkun Kombëtar të Alpeve të Shqipërisë**

**Detajet e Kontaktit të Prefektura Shkodër:**

Adresa Fizike: Prefektura e Qarkut Shkodër, Rruga “28 Nëntori”, Shkodër, Shqipëri;

E-mail: [Prefekti.Shkoder@mb.gov.al](mailto:Prefekti.Shkoder@mb.gov.al)

**Detajet e Kontaktit të Prefektura Kukës:**

Adresa Fizike: Prefektura e Qarkut Kukës, Sheshi “Skënderbej”, Kukës

E-mail: [prefekti.kukes@mb.gov.al](mailto:prefekti.kukes@mb.gov.al)

- 11) Nëse ankimuesi nuk është i kënaqur me përgjigjen, ose nëse ankimuesi dëshiron të paraqesë një ankesë tjetër në lidhje me shqetësimin e ngritur, kjo ankesë mund të paraqitet pranë AKZM, <https://akzm.gov.al/programi-i-transparences/>
- 12) Nëse ankimuesi nuk është i kënaqur me përgjigjen, ose nëse ankimuesi dëshiron të paraqesë një ankesë tjetër në lidhje me shqetësimin e ngritur, kjo ankesë mund të paraqitet pranë MTM, <https://turizmi.gov.al/programi-i-transparences-2-2/>
- 13) Nëse ankimuesi nuk është i kënaqur me përgjigjen, ose nëse ankimuesi dëshiron të paraqesë një ankesë tjetër në lidhje me shqetësimin e ngritur, kjo ankesë mund të paraqitet pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
  
[https://www.pyetshtetin.al/wp-content/uploads/2022/07/Model\\_Format\\_Ankese.pdf](https://www.pyetshtetin.al/wp-content/uploads/2022/07/Model_Format_Ankese.pdf) si edhe pranë Platformës për Bashkëqeverisjen “Për Shqipërinë që duam” <https://www.shqiperiaqeduam.al/#shtetiNeSHerbim>
- 14) Në rastet kur ankesa nuk merret në konsideratë, Ligji Nr. 44/2015 “Për Kodin e Procedurave Administrative” <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/135-ligj-nr-44-2015-kodi-i-procedurave-administrative-i-republikes-se-shqiperise> rregullon procedurën për apel administrative.